



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1795/6 Prot

Tiranë, më 01.12.2022

VENDIM

Nr.56, datë 01.12.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Emisioni “Piranjat”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1795 Prot., datë 18.10.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, fillimisht nëpërmjet kërkesës për informacion datë 10.08.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Listën e subjekteve fituese si Start-up, si lehtësues Start-up dhe si lehtësues Start-up-esh të përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit, sipas shtojcës 1 të cituar në VKM e datës 16 Korrik.
2. Listën me emrat e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të ngritur pranë Ministrinë të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Autoriteti Publik me shkresën nr. 4735 Prot., datë 17.08.2022, ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion linkun përkatës në të cilin ndodhet informacioni i publikuar lidhur me listën e subjekteve fituese, përkatësisht pika 1 e kërkesës për informacion.

Ndërkohë lidhur me pikën 2 të kërkesës, ka informuar mbi përbërjen, periudhën si dhe institucionin përgjegjës nga ku caktohet çdo anëtar i Komisionit sipas VKM-së nr 313, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”.

Në vijim, kërkuesi i është drejtuar përsëri Autoritetit Publik me kërkesën datë 26.09.2022, duke cituar se: *në përgjigjen e shkresës nr. 4735, datë 17.08.2022, shpjegohet përbërja, periudha e mandatit si dhe institucioni përgjegjës nga ku caktohet çdo anëtar i këtij Komisioni por jo emrat e anëtarëve. Për këtë arsye, u depozitua një kërkesë për informacion pranë Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët si një nga institucionet përgjegjëse në përbërje të këtij Komisioni. Ky i fundit, si përgjigje të shkresës ka bërë me dije se çdo kërkesë për informacion lidhur me përbërjen apo ushtrimin e detyrave të Komisionit të Vlerësimit të grantit për mbështetjen e start up-eve, duhet të përcillet pranë Institucionit të ngarkuar për të administruar këtë proces... Në këto kushte, kërkohet nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, vënia në dispozicion të emrit të personit përgjegjës anëtar të Komisionit të Vlerësimit të grantit për mbështetjen e start up-eve dhe lehtësuesëve të caktuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 4735/2 Prot., datë 13.10.2022, ka sqaruar se: *“a. Sipas kreut II pika 3 e VKM-së nr. 313, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe të kritereve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”, Komisioni i vlerësimit të dhënies së grantit për mbështetjen e start up-eve dhe lehtësuesve kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe përbëhet nga 4 (katër) anëtarë të tjerë të zgjedhur me mandat për periudhën e disbursimit të grantit maj – dhjetor 2022, me të drejtën rizgjedhjeje.*

Për sa kohë nuk jemi gjendur në një nga kushtet e përcaktuara në pikën 5 të VKM-së, që lidhen me arsyet e mbarimit të mandatit apo shkarkimit të anëtarit të komisionit, këta të fundit kanë një mandat të vlefshëm dhe madje kanë edhe të drejtë të rizgjidhen në thirrjet e ardhshme.

Për sa më sipër, përcjellja e emrave të tyre mund të bëhet shkak për të ndikuar në proceset e ardhshme të vlerësimeve, në paanshmërinë dhe integritetin e tyre duke ndikuar në proceset e vendimmarrjes objektive.

b. Përmendim gjithashtu se vendi ynë ka nënshkruar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, në zbatim të së cilës ushtron funksionin e saj Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Kjo e fundit në një rast të ngjashëm, duke shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Komunitetit Europian, ka vendosur ndër të tjera edhe mos përcjelljen e emrave të anëtarëve të komisionit pasi kjo konsiderohet shkelje e të dhënave personale të tyre dhe si argument ndër të tjera trajtohet edhe fakti që anëtarët e zgjedhur nuk kanë nënshkruar ndonjë dokument në të cilin të shprehet dakordësia për përcjelljen e emrave të tyre. Bazuar në sa më sipër, nuk mund të përcjellim emrat e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit”.

Në vijim, pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se: *“...në pikën 4 të nenit 14 të ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e start up-eve”, parashikohet se: “Me*

qëllim vlerësimin e kërkesave nga startup-et dhe lehtësuesit e startup-eve ngrihet komisioni i vlerësimit, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen”. Pra, automatikisht një nga emrat (në këtë rast e kryetarit të komisionit) është bërë publike, si rrjedhojë bie pretendimi i Autoritetit Publik. Në këtë mënyrë nuk mund të merret si referim rasti “C-28/08 P, Bavarian Lager v Commission”, i referuar prej tij. Në çështjen e sipërcituar, bëhet fjalë për minutat e takimit, opinionin e secilit pjesëmarrës në këtë takim dhe emrat e tyre. Si edhe kuptohet lehtësisht se kjo nuk ka të bëjë me kërkesën për informacion ku kërkohen vetëm emrat e anëtarëve të këtij komisioni dhe jo vendimet e marra prej tyre.

Për analogji, para disa ditësh është zhvilluar në Tiranë konkursi i hapur për përzgjedhjen e studios së arkitekturës për të prezantuar projektet e tyre për kullën që propozohet të ngrihet mbi lulishten pas TOB, ku përbërja e jurisë, në rastin tonë komisioni, është bërë publike për median”.

Në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, duke kërkuar vënien në dispozicion të emrave të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të grantit për mbështetjen e start up-eve dhe lehtësuesve.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 1795/1 prot., datë 25.10.2022, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe argumentin përkatës në rast të kufizimit të të drejtës për informim, bazuar në nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ose legjislacionin e posaçëm.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 5897/1 Prot., datë 01.11.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1795/2 Prot., datë 04.11.2022, ka sqaruar se: “*...në pikën 4 të nenit 14 të ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve” por edhe në VKM nr. 313, datë 11.05.2022, përcaktohet përbërja e Komisionit të Vlerësimit të granteve sipas të cilit ky i fundit kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen. Ankuesi pretendon se përsa kohë një nga emrat e anëtarëve të komisionit është bërë publik, nuk mund të merret për referencë rasti C-28/08 P, Bavarian Lager v Commission.*

Referuar kësaj pike ligji përcakton Ministrin si kryetarin e komisionit dhe përsa kohë ligji është publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë, emri i tij është publik.

Për më tepër ministri si strukturë përgjegjëse e ligjit “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startupeve” si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ka marrë pjesë të vazhdueshme në

diskutimin, vlerësimin dhe hartimin e këtyre akteve duke shprehur edhe dakordësinë për publikimin e emrit të tij. Njësoj edhe në rastin e C-28/08 P, Bavarian Lager v Commission, disa anëtarë kanë firmosur për dakordësinë e përcjelljes së emrave të tyre e disa të tjerë jo, për arsyet e përmendura në vendimin e GJEDNJ.

Për këtë arsye, për analogji emrat e anëtarëve të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin nuk mund të përcillen.

Referuar pikës 5 të VKM-së së sipërcituar, që lidhen me arsyet e mbarimit të mandatit apo shkarkimit të anëtarit të komisionit, konstatohet se përsa kohë nuk ka ndodhur ndonjë nga situatat që sipas VKM-së cakton mbarimin e mandatit apo shkarkimin e komisionerëve, këta të fundit kanë një mandat të vlefshëm dhe madje kanë edhe te drejtë të rizgjidhen në thirrjet e ardhshme.

Pikërisht, për të evituar ndikimin në paanshmërinë, integritetin dhe cënimin e procesit të vlerësimit gjykohet se është me vlerë mospërcjellja e emrave të tyre pasi kjo nuk bie në kundërshtim me interesa publikë.

Përsa më sipër ky informacion nuk mund të përcillet”.

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, Komisioneri, bazuar në nenet 53, 91 dhe 92 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 1795/3 Prot., datë 08.11.2022 “Për zgjatjen e afatit të procedurës administrative”, vendosi shtryrjen e afatit të përfundimit të procedurës deri me datë 01.12.2022.

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 22.11.2022 me prezencën e përfaqësuesëve të ankuesit dhe Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e ankuesit rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar vënie në dispozicion të emrave të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të grantit për mbështetjen e start up-eve dhe lehtësuesve.

Ndërkohë edhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik, rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, i kërkoi përfaqësuesëve të Autoritetit Publik, argumentimin përkatës në të cilin bazohet kufizimi i së drejtës për informim, në përputhje me nenin 17 të LDI. Në vijim, këta të fundit u shprehën se e mbështesin kufizimin bazuar në shkronjën a), të pikës 1 të nenit 17 të LDI, në të cilën parashikohet se: “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton a) të drejtën për një jetë private...”

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, nisur nga informacioni që kërkohet, kjo

çështje duhet të trajtohet me LDI, por edhe me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të sipërcituara, rezulton se Autoriteti Publik, ka përmbushur detyrimin duke vendosur në dispozicion informacionin lidhur me pikën 1 të kërkesës për informacion datë 10.08.2022, për të cilën nga ana e ankuesit nuk është depozituar ankim. Ndërkohë, për sa i përket pikës 2 të kërkesës për informacion datë 10.08.2022 si edhe kërkesës datë 26.09.2022 (e cila përfshihet si informacion në pikën 2 të kërkesës së parë datë 10.08.2022) Autoriteti Publik ka informuar mbi përbërjen, periudhën si dhe institucionin përgjegjës nga ku caktohet çdo anëtar i Komisionit sipas VKM-së nr 313, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e Komisionit të Vlerësimit, si dhe kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”, si dhe ka vendosur në dispozicion vetëm emrin e njërit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të ngritur pranë Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes përkatësisht, ministrin përgjegjës për sipërmarrjen por nuk ka vendosur në dispozicion emrat e anëtarëve të tjerë të këtij komisioni, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesat për informacion mbi të cilat është depozituar ankesa.

Në qëndrimin e Autoritetit Publik Komisioneri konstaton se, kufizimi i informacionit është bërë në referim të *rastit C-28/08 P, Bavarian Lager v Commission, shkronjës “a” të pikës 1 të LDI si edhe argumentit se: përcjellja e emrave të tyre mund të bëhet shkak për të ndikuar në proceset e ardhshme të vlerësimeve, në paanshmërinë dhe integritetin e tyre duke ndikuar në proceset e vendimmarrjes objektive*, pa marrë parasysh dispozitat përjashtuese të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Referuar këtij legjislacioni, në parim, e drejta e aksesit në të dhënat personale sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është një e drejtë që gëzohet nga subjekti i të dhënave personale. Kërkesat për informacion të paraqitura nga ankuesi bazohen në LDI dhe në nenin 17 të tij jepen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, ku një nga kufizimet është edhe ruajtja e jetës private.

Ndërkohë, në rastin konkret, informacioni i kërkuar lidhet me ushtrimin e detyrës funksionale (emër, mbiemër) të punonjësve të autoriteteve publike që janë krijuar si strukturë e posaçme bazuar në ligjin nr.25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e start up-eve” dhe VKM-në nr. 313, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e komisionit të vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”. Rrjedhimisht, në këto kushte, Komisioneri vlerëson se gjen zbatim shkronja b) e pikës 4 të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohet se: *“Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”*.

Ky parashikim aplikohet sipas legjislacionit në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë të të dhënave. Në këtë kuptim, përhapja e informacionit duhet të kufizohet vetëm me aksesimin e dokumenteve të dosjes personale të subjektit të

të dhënave (*të dhëna të dosjes personale të funksionarit publik*) që përmbajnë të dhëna personale të lidhura ngushtësisht me individin dhe, si të tilla, nuk mund të vendosen në dispozicion të askujt pa pëlqimin paraprak të tij.

Ndërkohë, nga verifikimi i kërkesave për informacion rezulton se ajo konsiston vetëm në marrjen e informacionit mbi emrat e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit dhe jo aksesimin e dokumentacionit që përmban të dhëna personale apo të mendimeve të shprehura nga këto anëtarë, për të cilat edhe mund të qëndrojnë argumentat e paraqitura nga Autoriteti Publik.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, në këtë rast e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale ushtrohet në përputhje me të drejtën e aksesit të publikut në dokumente zyrtare të mbajtura nga një autoritet publik, si dhe në përputhje me të drejtën për informim dhe aksesin e publikut në informacionin që lidhet me një person nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje që lidhen me kryerjen e funksioneve dhe detyrave zyrtare të tij, me përjashtim të rasteve specifike ose kategorive të rasteve specifike kur për mbrojtjen e të drejtave të tjera themelore të tij nevojitet mbrojtja e të dhënave personale.

Ndërkohë, përkufizimi i termit “Zyrtar” zbërthehet specifikisht në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, sipas të cilit “Zyrtar” është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike. Gjithashtu sipas parashikimit të nenit 4 të po këtij ligji, brenda sferës së këtij përkufizimi përfshihet çdo zyrtar që merr pjesë në një vendimarrje.

Për sa i përket anëtarit ekspert të ekosistemit të start up-eve, i cili nuk është funksionar publik apo zyrtar, në kuptim të ligjit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se ky informacion duhet të jetë publik, bazuar kjo në pikën 4 të VKM-së nr. 313, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për përbërjen e komisionit të vlerësimit, si dhe të kriterëve, procedurës së përzgjedhjes dhe shpërblimit të anëtarëve të tij”, në të cilën parashikohet se: “Anëtari ekspert i ekosistemit, parashikuar në shkronjën “ç”, të pikës 3, të këtij vendimi, do të përzgjidhet mbi bazën e një procesi transparent konkurrimi, pas shpalljes së thirrjes për ekspertë të publikuar në faqen e ministrisë përgjegjëse për sipërmarrjen...”

Lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se: “..për të evituar ndikimin në paanshmërinë, integritetin dhe cenimin e procesit të vlerësimit gjykojmë që është me vlerë mos përcjellja e emrave të tyre, pasi kjo bie në kundërshtim me interesat publike”, Komisioneri vlerëson se, kuadri rregullator shqiptar ka parashikuar mjaftueshëm instrumente të tjerë ligjor për të garantuar zbatimin e këtyre parimeve nga zyrtari publik gjatë ushtrimit të funksionit të tij, për rrjedhojë prezumohen të ditura të gjitha legjislacionet përpara çdo vendimarrje sipas fushës përkatëse. Po ashtu, ky shkak kufizimi i paraqitur nga ana e Autoritetit Publik nuk parashikohet as në nenin 17 të LDI, i cili parashikon rastet e kufizimit të informacionit publik, dhe as në ndonjë dispozitë ligjore e legjislacionit të posacëm.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur Autoriteti Publik pranon zotërimin e informacionit, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*. Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit informacionin në formatin e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Gjithashtu, konstatohet se kërkuar/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1795 Prot., datë 18.10.2022, nga Emisioni “Piranjat”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikës 2 të kërkesës për informacion datë 10.08.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 09.12.2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 01.12.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi